

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Ankesë kundër: SPITALI REGJIONAL – PRIZREN

Numri i Prokurimit: 220/70010-26-5478-5-5-8

Sa i përket tenderit për: “Furnizim me Inventar Administrativ për repartet Pediatrike & Internistike Spitali i Përgjithshëm Prizren”

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“IBM” SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Ulqinit PN

(Adresa)

Mitrovice

(Vendi)

044/746-641

(Numri Telefonit)

40.000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Ermal Bajraktari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkibmoffice@gmail.com

(Adresa elektronike)



24.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

/

Shëno të dhënat si në vijim:

_____ / _____

(Emri i avokatit)

/_____
(Adresa e plotë)

/_____
(Numri i Telefonit)

/_____
(Numri i faks-it)

/_____
(Adresa elektronike)

/_____
(Data e parashtrimit të kërkesës)

/_____
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate 08.07.2026 14:10
Hapja e tenderit 14.07.2026 në 13:00
B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 14.07.2026 13:23
B58 Njoftim mbi vendimin e AK 06.08.2026 14:52
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 14.08.2026 15:26

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbalin e hapjes se ofertave e kemi pranuar ne e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Letren standarde per tenderuesin e eliminuar e kemi pranuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ne e-prokurim.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Konsiderojmë se gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues/Komisioni Vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, dhe dispozitat përkatëse të Udhëzimit Operativ për Prokurimin Publik, në veçanti:

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi dhe Transparenca;
- Neni 27 i LPP-së – Dosja e Tenderit;
- Neni 28 i LPP-së – Specifikimet Teknike;
- Neni 59, paragrafët 2 dhe 4 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës;
- Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë;
- Neni 37 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – Mostrat;
- Neni 38 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – Sqarimi i Tenderëve;
- Neni 39 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – Komisioni Vlerësues;
- Neni 40, në veçanti paragrafët 40.2, 40.6, 40.7 dhe 40.8 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

7. Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues/Komisioni Vlerësues, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, si dhe gjatë trajtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga IBM SH.P.K., nuk ka siguruar zbatimin e njëjtë, objektiv dhe të barabartë të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Vetë Ftesa për Ofertim përcakton se oferta duhet të jetë në përputhshmëri me kërkesat e FPO-së dhe se Autoriteti Kontraktues nuk pranon ndryshime. Po ashtu, është përcaktuar se furnizimet duhet të jenë plotësisht në pajtim me specifikimet teknike dhe se mospërputhshmëria me një specifikim mund të rezultojë në diskualifikimin e tenderit.

Në anën tjetër, Neni 40.2 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, versioni i konsoliduar, përcakton se tenderët duhet të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit dhe se Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë apo heqë kërkesat, kriteret ose specifikimet e përcaktuara paraprakisht gjatë procesit të vlerësimit.

7.1. Autorizimi i prodhuesit – paqartësitë mbi identitetin juridik, fushëveprimin, vlefshmërinë dhe autenticitetin e dokumenteve të paraqitura

Dosja e Tenderit në mënyrë të qartë ka përcaktuar kërkesën që **“OE duhet të ketë dhe dorëzojë autorizim nga prodhuesi për karriga”**. Për rrjedhojë, ekzistenca dhe vlefshmëria e autorizimit nga prodhuesi nuk paraqet element formal të parëndësishëm, por kërkesë të drejtpërdrejtë të dokumentacionit të tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur dy dokumente të ndryshme: **“Cooperation Agreement” të datës 20.05.2017** dhe **“Manufacturer Authorization” të datës 22.03.2019**.

IBM SH.P.K. nuk deklaroi si fakt të provuar se këto dokumente janë të falsifikuara. Megjithatë, për shkak të mospërputhjeve dhe paqartësive konkrete të evidentuara më poshtë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur të arrijë në përfundim të sigurt mbi vlefshmërinë dhe fushëveprimin e autorizimit pa kryer verifikim objektiv dhe të drejtpërdrejtë të lëshuesit të dokumentit, përkatësisht Compotek S.r.l.

a) Mospërputhja në identifikimin e subjektit të autorizuar dhe nevoja për verifikimin e gjendjes historike në ARBK

Në dokumentin **“Cooperation Agreement” të datës 20.05.2017**, pala kosovare identifikohet si:

“Galanteria LLC, St. Ismail Qemali pn, 11000 Podujeve, Republic of Kosovo, represented by Nderim Ymeri, CEO”.

Ndërsa në dokumentin **“Manufacturer Authorization” të datës 22.03.2019**, subjekti të cilit pretendohet se i jepet autorizimi paraqitet vetëm si **“Galanteria shpk”**.

Në këtë dokument të vitit 2019 nuk figuron NUI i Galanteria-s, numri i regjistrimit të biznesit, adresa e plotë e subjektit të autorizuar apo ndonjë identifikues tjetër unik që do ta lidhte në mënyrë të pakontestueshme dokumentin me subjektin juridik që ka ofertuar në aktivitetin konkret.

Vetëm deklarimi i AK-së se “LLC” është ekuivalent në gjuhën angleze i “SH.P.K.” nuk i përgjigjet pyetjes faktike:

A ka qenë “Galanteria LLC” emri zyrtar, emri tregtar i regjistruar apo versioni i regjistruar në gjuhën angleze i këtij subjekti në ARBK më 20.05.2017?

Për këtë arsye kërkojmë nga OSHP/Eksperti Shqyrtues që të sigurojë nga ARBK **gjendjen historike të regjistrimit të subjektit për datën 20.05.2017 dhe për datën 22.03.2019**, duke verifikuar së paku:

- a) emrin zyrtar të regjistruar në secilën datë;
- b) formën juridike;
- c) numrin e regjistrimit/NUI;
- d) adresën e regjistruar;
- e) përfaqësuesin/personin e autorizuar;

f) çdo ndryshim eventual të emrit ose të të dhënave të biznesit ndërmjet këtyre dy datave.

Ky verifikim është veçanërisht i rëndësishëm pasi dokumenti i vitit 2017 nuk përmban NUI apo numër unik regjistrimi të Galanteria-s, ndërsa autorizimi i vitit 2019 e identifikon subjektin pothuajse vetëm përmes emrit.

Prandaj, identiteti juridik i palës së autorizuar duhet të **provohet me dokumentacion historik zyrtar dhe jo të prezumohet vetëm mbi bazën e ngjashmërisë së emrit.**

b) “Cooperation Agreement” i vitit 2017 nuk duhet ngatërruar me “Manufacturer Authorization” të vitit 2019

Në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, AK është mbështetur në faktin se marrëveshja e bashkëpunimit e datës 20.05.2017 ka vlefshmëri dhjetë (10) vjet.

IBM SH.P.K. nuk e konteston se në fund të **“Cooperation Agreement”** është shkruar:

“The validity of this agreement is ten years, from the date of signing.”

Pra, afati dhjetëvjeçar ekziston. Mirëpo ky afat i referohet shprehimisht **“this agreement”**, përkatësisht marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2017.

Çështja që AK nuk e ka sqaruar është se në vitin 2019 është lëshuar një **dokument tjetër**, me titull tjetër – “Manufacturer Authorization” – i cili ka formulim dhe qëllim tjetër.

Në autorizimin e datës 22.03.2019 nuk është shkruar se ai është i vlefshëm për dhjetë vjet dhe as nuk është shkruar se është autorizim i përgjithshëm për të gjitha procedurat e prokurimit deri në vitin 2027.

Përkundrazi, dokumenti i vitit 2019 deklaron se Galanteria autorizohet:

“to participate and sign a contract for above-mentioned tender.”

Problemi esencial është se në vetë dokumentin nuk identifikohet askund se cili është ky **“above-mentioned tender”**. Nuk figuron:

- a) numri i prokurimit;
- b) titulli i tenderit;
- c) Autoriteti Kontraktues;
- d) objekti i prokurimit;
- e) data e tenderit;
- f) apo ndonjë referencë tjetër që mundëson identifikimin e tenderit për të cilin është lëshuar autorizimi.

Nga dokumenti, pra, nuk mund të përcaktohet në mënyrë objektive **për cilin tender konkret është lëshuar autorizimi i datës 22.03.2019.**

Pikërisht këtu arsyetimi i AK-së është i mangët. AK ka marrë afatin dhjetëvjeçar të **marrëveshjes së vitit 2017** dhe e ka përdorur për të justifikuar vlefshmërinë e dokumentacionit të autorizimit në procedurën e vitit 2026, pa e sqaruar fushëveprimin e dokumentit specifik të vitit 2019.

Nëse marrëveshja e vitit 2017 do të ishte vetvetiu autorizim i plotë dhe i pakufizuar për pjesëmarrje në çdo tender për dhjetë vjet, atëherë lind pyetja objektive:

Përse Compotek S.r.l. ka pasur nevojë të lëshojë më 22.03.2019 një dokument tjetër të veçantë me titull “Manufacturer Authorization”, i cili shprehimisht i referohet një “above-mentioned tender”?

Kjo pyetje nuk është trajtuar në mënyrë të argumentuar në vendimin e AK-së dhe nuk mund të zgjidhet me supozim.

c) Vetë marrëveshja e vitit 2017 parashikon marrëveshje të veçanta për “larger projects”

Një element tjetër material, të cilin AK nuk e ka trajtuar në mënyrë të plotë, gjendet në vetë “Cooperation Agreement” të vitit 2017.

Në të thuhet shprehimisht:

“Both companies agree that for larger projects, they will reach special agreements, with special conditions.”

Pra, vetë palët kanë paraparë që për **projekte më të mëdha** do të arrijnë **marrëveshje të veçanta me kushte të veçanta**.

Aktiviteti konkret i prokurimit ka vlerë prej **198,289.00 €**.

IBM SH.P.K. nuk pretendon se marrëveshja e vitit 2017 përcakton ndonjë kufi monetar se prej cilës vlerë një projekt konsiderohet “larger project”, sepse dokumenti nuk përmban një definicion të tillë.

Pikërisht për këtë arsye AK nuk ka bazë që këtë dispozitë ta interpretojë vetë në favor të OE të rekomanduar ose ta konsiderojë të parëndësishme pa pyetur palën që e ka hartuar dhe nënshkruar dokumentin.

Duhet të kërkohej nga **Compotek S.r.l.** që të sqarojë se çfarë nënkuptohet me “larger projects”, nëse aktiviteti konkret me vlerë 198,289.00 € hyn në këtë kategori dhe, nëse po, nëse për këtë aktivitet është lidhur ndonjë marrëveshje apo autorizim i veçantë.

Kjo çështje merr rëndësi edhe më të madhe kur shihet së bashku me dokumentin e vitit 2019, sepse vetë ekzistenca e një **“Manufacturer Authorization” të veçantë për një tender** demonstroi se palët kanë përdorur dokumente specifike autorizimi për procedura të caktuara.

Kërkesa konkrete për verifikim lidhur me pikën 7.1

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e mësipërme, IBM SH.P.K. konsideron se AK nuk ka pasur bazë të mjaftueshme që këto çështje t'i refuzojë vetëm si “dyshime” pa ndërmarrë verifikim.

Në bazë të parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë të përcaktuara me Nenin 7 të LPP-së, si dhe dispozitave lidhur me ekzaminimin dhe sqarimin e dokumentacionit të tenderit, kërkojmë që OSHP/Eksperti Shqyrtues të bëjë verifikim të plotë të këtij

pretendimi.

Në veçanti kërkojmë:

- a) të sigurohet nga ARBK ekstrakti/gjendja historike e Galanteria-s më **20.05.2017**;
- b) të sigurohet nga ARBK ekstrakti/gjendja historike e Galanteria-s më **22.03.2019**;
- c) të verifikohet nëse “Galanteria LLC” dhe “Galanteria SH.P.K.”, siç figurojnë në dokumentet e paraqitura, i referohen në mënyrë të provueshme të njëjtit subjekt juridik;
- d) të kërkohet nga OE i rekomanduar **origjinali ose kopja e plotë dhe e pacenuar** e “Manufacturer Authorization” të datës 22.03.2019;
- e) të kërkohet drejtpërdrejt nga **Compotek S.r.l.**, përmes të dhënave zyrtare të kontaktit të kompanisë dhe jo vetëm përmes OE të rekomanduar, që të konfirmojë nëse “Cooperation Agreement” i datës 20.05.2017 është dokument autentik i kompanisë;
- f) të konfirmojë nëse “Manufacturer Authorization” i datës 22.03.2019 është dokument autentik i kompanisë;
- g) të konfirmojë identitetin e plotë juridik, numrin e regjistrimit dhe adresën e subjektit kosovar të cilit i janë lëshuar dokumentet;
- h) të identifikojë saktësisht se cili është **“above-mentioned tender”** i përmendur në autorizimin e datës 22.03.2019;
- i) të konfirmojë nëse autorizimi i vitit 2019 ka qenë autorizim vetëm për atë tender apo autorizim i përgjithshëm;
- j) të konfirmojë nëse Galanteria SH.P.K. kishte, në datën **14.07.2026**, autorizim të vlefshëm dhe të aplikueshëm nga Compotek S.r.l. për aktivitetin konkret me nr. **220/70010-26-5478-5-5-8**;
- k) të sqarojë kuptimin dhe fushëveprimin e dispozitës **“for larger projects, they will reach special agreements, with special conditions”**, si dhe nëse për aktivitetin konkret është dashur ose është lidhur marrëveshje/autorizim i veçantë;
- l) të konfirmojë nëse personi që figuron si nënshkrues në secilin dokument ka pasur autorizim për përfaqësimin dhe nënshkrimin në emër të Compotek S.r.l. në datën përkatëse.

Përfundimisht, theksojmë se IBM SH.P.K. **nuk kërkon që OSHP të shpallë dokumentet të falsifikuara vetëm mbi bazën e këtyre mospërputhjeve**. Kërkojmë pikërisht të kundërtën: që për një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit të mos bëhen supozime as në favor dhe as në dëm të ndonjë operatori, por të përcaktohet gjendja faktike përmes **verifikimit zyrtar në ARBK dhe konfirmimit të drejtpërdrejtë nga Compotek S.r.l.**

Nëse nga ky verifikim nuk konfirmohet autenticiteti, identiteti i subjektit të autorizuar ose fushëveprimi i autorizimit për aktivitetin konkret, atëherë dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet se dëshmon përmbushjen e kërkesës së FPO-së që OE të ketë dhe të

dorëzohet autorizim nga prodhuesi për karrige.

7.2. Certifikata EN 16955:2017 nuk është lëshuar në emër të prodhuesit të deklaruar të karrigeve

Dosja e Tenderit në pikën f) ka përcaktuar shprehimisht:

“Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar për standardet EN-1335-1, EN-1335-2, EN-16139, EN 16955:2017 dhe UNI EN ISO 16009:2024.”

Formulimi i kërkesës është i drejtpërdrejtë: kërkohet që **prodhuesi** të jetë i certifikuar.

Në dokumentacionin e paraqitur nga OE Galanteria SH.P.K., certifikata EN 16955:2017 identifikon si **License Holder – Korea Gas Spring Co., Ltd., Republic of Korea**, ndërsa produkti i certifikuar identifikohet si “Tapered pressure tubes”.

Pra, dokumenti nuk identifikon Compotek S.r.l. si mbajtës të certifikatës EN 16955:2017.

Nëse prodhuesi i deklaruar i karrigeve të ofruara është Compotek S.r.l., atëherë certifikata në emër të një kompanie tjetër nuk dëshmon vetvetiu se **prodhuesi Compotek S.r.l. është i certifikuar** sipas standardit të kërkuar.

AK në përgjigjen e tij e ka interpretuar dokumentin si të mjaftueshëm për shkak se ai i referohet një komponenti të produktit. Mirëpo Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar “prodhuesi i një komponenti duhet të jetë i certifikuar”; ka kërkuar **“Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar”**.

Sipas Nenit 40.2 të Rregullores, AK nuk mund të ndryshojë, modifikojë apo heqë gjatë vlerësimit kërkesën e përcaktuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Për këtë arsye kërkojmë nga OSHP të verifikojë se kush është prodhuesi i deklaruar për produktet e ofruara dhe nëse pikërisht ai subjekt juridik e posedon certifikimin EN 16955:2017 të kërkuar nga FPO-ja.

7.3. Mospërputhjet ndërmjet certifikatave/testimeve dhe produkteve konkrete të ofruara

Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar vetëm ekzistencën e përgjithshme të standardeve.

Në pikën g) është kërkuar certifikata EN 1335 dhe testime nga laboratorë të licencuar për **artikujt nr. 10, 11 dhe 12**, ndërsa në pikën h) është kërkuar EN 16139 dhe testime për **artikujt nr. 6, 29 dhe 34**.

Pra, vetë AK i ka lidhur dokumentet e testimit me artikuj konkretë të ofertës.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga OE Galanteria SH.P.K. rezulton se karriget e paraqitura në raportet e testimit nuk janë të njëjtat me karriget e paraqitura në katalog dhe mostrat fizike për artikujt përkatës.

AK në vendimin e tij është mbështetur në faktin se certifikatat janë autentike dhe se identiteti vizual nuk është domosdoshmërisht vendimtar.

Mirëpo këtu kemi dy çështje juridikisht dhe teknikisht të ndryshme:

a) a është dokumenti autentik; dhe

b) a mbulon ai dokument produktin konkret të ofertuar.

Fakti që një raport testimi është autentik nuk dëshmon automatikisht se ai raport vlen për çdo model tjetër të të njëjtit prodhues.

Nëse raporti i testimit vlen për një familje të caktuar modelesh apo konfigurime të ndryshme, atëherë një gjë e tillë duhet të provohet përmes dokumentacionit të laboratorit ose prodhuesit dhe jo të prezumohet nga Autoriteti Kontraktues.

Për këtë arsye kërkojmë që OSHP të bëjë verifikim të drejtpërdrejtë për secilin artikull të kërkuar:

artikulli i FPO-së → modeli i deklaruar në katalog → modeli/referenca në raportin e testimit → konfigurimi i testuar → mostra fizike e dorëzuar.

Nëse kjo lidhje nuk mund të vërtetohet dokumentarisht, nuk mund të konsiderohet se vetëm ekzistenca e një raporti testimi për një produkt tjetër plotëson kërkesën specifike të Dosjes së Tenderit.

7.4. Pozicioni nr. 6 – Dimensioni 1420 mm, ndryshimi i kërkesës pas hapjes dhe ngatërrimi i mostrës së IBM SH.P.K.

Për pozicionin nr. 6 – Karrige Bari, Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht:

“Dimensionet totale: 450 x 460 x 1420h mm.”

Po ashtu, ka përcaktuar se karrigia duhet të jetë e njëjtë/identike sipas specifikacionit, karakteristikave, dimensioneve dhe fotografive/skicimeve të bashkëngjitura, duke lejuar devijim maksimal $\pm 5\%$.

Edhe nëse në favor të operatorit aplikohet devijimi maksimal prej -5% , lartësia minimale do të ishte **1349 mm**.

Mostra e OE Galanteria SH.P.K., sipas verifikimit tonë fizik, ishte rreth **1170 mm**, pra dukshëm jashtë kufirit të lejuar.

Autoriteti Kontraktues, në vendimin e datës 14.08.2026, nuk e mohon se dimensionin 1420 mm ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit. Përkundrazi, deklaroi se ky dimension ka qenë një “gabim teknik” i AK-së dhe se nuk duhet të konsiderohet kërkesë reale.

Ky arsyetim është në kundërshtim me Nenin 40.2 të Rregullores, sipas të cilit kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara paraprakisht nuk mund të ndryshohen, modifikohen apo hiqen gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

Operatorët ekonomikë e kanë përgatitur ofertën dhe mostrat në bazë të Dosjes së Tenderit të hartuar nga vetë AK. IBM SH.P.K. e ka respektuar dimensionin e kërkuar. Nuk mund të vendoset pas hapjes së ofertave se një kërkesë materiale e shkruar nga AK nuk do të merret më parasysh vetëm për shkak se një operator tjetër nuk e ka përmbushur.

Nëse AK e ka konsideruar dimensionin 1420 mm gabim, ai gabim është dashur të korrigjohet para përfundimit të afatit për dorëzim të ofertave dhe të komunikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët.

Përveç kësaj, në vendimin mbi rishqyrtimin AK i referohet një karrigeje për të cilën pretendon se ulësja ishte fiksuar në mënyrë jo adekuate dhe se gjatë testimit ishte shkëputur.

IBM SH.P.K. deklaron se **kjo nuk ka qenë mostra e IBM SH.P.K.**

Përfaqësuesi ynë ka qenë personalisht i pranishëm gjatë qasjes në mostra dhe mostra së cilës i referohet ky përshkrim i përkiste një operatori tjetër ekonomik. Karrigia e IBM SH.P.K. nuk ka pësuar defektin e përshkruar nga AK.

Për këtë arsye nuk kërkojmë që OSHP ta pranojë deklarinë tonë pa verifikim. Përkundrazi, kërkojmë verifikim të plotë të gjurmueshmërisë së mostrave.

Neni 37.4 i Rregullores përcakton se para procesit të vlerësimit duhet të eliminohen shenjat që identifikojnë OE dhe mostrat duhet të kodohen, ndërsa Neni 37.5 përcakton se personi që vendos kodet nuk duhet t'ia zbulojë identitetin e mostrave Komisionit Vlerësues. Neni 37.6 përcakton se mostrat janë pjesë e tenderit dhe pjesë e testit teknik.

Për këtë arsye kërkojmë nga OSHP/Eksperti Shqyrtues të administrojë:

- regjistrin e pranimi të mostrave;
- kodet e vendosura në secilën mostër;
- fotografitë e mostrave në momentin e pranimi;
- procesverbalet e testimit;
- kodin e mostrës e cila pretendohet se është shkëputur;
- identifikimin e OE-së të cilit realisht i përket ajo mostër.

IBM SH.P.K. kërkon që mostra e saj të ekzaminohet fizikisht dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, të testohet në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtat kushte me mostrat e operatorëve tjerë.

Nëse verifikohet se defekti i një mostre të një OE tjetër është atribuar në vendim mostrës së IBM SH.P.K., atëherë kemi të bëjmë me një gabim faktik esencial në vlerësimin e ofertës sonë.

7.5. Mospërputhja e materialit MDF dhe nevoja për verifikim profesional për secilin produkt

Në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit, për një numër produktesh është kërkuar shprehimisht material **MDF melamine**, me trashësi konkrete 18 mm, 36 mm dhe karakteristika të tjera teknike.

Gjatë qasjes fizike në mostrat e OE Galaneria SH.P.K., është konstatuar se në produktet e kontestuara materiali i përdorur nuk paraqiste karakteristikat e MDF-së së kërkuar, por të iverplakës.

AK në përgjigje është mjaftuar me konstatimin se pas ekzaminimit të mostrës materiali

rezulton të jetë MDF i melaminuar.

Mirëpo nuk është sqaruar:

- kush konkretisht e ka kryer identifikimin e materialit;
- çfarë kualifikimi profesional posedon personi që e ka bërë këtë identifikim;
- me çfarë metode është përcaktuar materiali;
- në cilat pjesë të produktit është kontrolluar bërthama;
- a ekziston raport, procesverbal, fotografi apo dokument teknik i prodhuesit mbi të cilin është bazuar konstatimi.

Për këtë arsye kërkojmë që **secili produkt i kontestuar për të cilin Dosja e Tenderit kërkon MDF të kontrollohet veçmas.**

Nuk duhet të nxirret përfundim i përgjithshëm për të gjitha produktet vetëm duke kontrolluar një artikull apo vetëm sipërfaqen e jashtme të materialit.

Nëse natyra e materialit nuk mund të përcaktohet me siguri përmes inspektimit profesional të mostrës, kërkojmë që të administrohet dokumentacioni teknik i prodhuesit dhe, sipas nevojës, të bëhet test/verifikim teknik i materialit.

Materiali i produktit nuk është çështje formale. MDF dhe iverpllaka janë materiale me strukturë dhe karakteristika të ndryshme dhe kur Dosja e Tenderit kërkon shprehimisht MDF, oferta duhet të vlerësohet sipas asaj kërkesë.

7.6. Pozicioni nr. 10 – Gjerësia minimale e mbështetëses

Për pozicionin nr. 10, Dosja e Tenderit ka kërkuar që mbështetësja e shpinës të ketë **gjerësi minimum 460 mm.**

Dosja parashikon gjithashtu mundësi devijimi prej $\pm 5\%$.

Gjatë matjes së mostrës së dorëzuar nga OE Galanteria SH.P.K., IBM SH.P.K. ka konstatuar gjerësi rreth **430 mm.**

Edhe në rast se toleranca prej -5% aplikohet ndaj vlerës 460 mm në mënyrën më të favorshme për OE fitues, kufiri i poshtëm do të ishte:

$$460 \text{ mm} - 5\% = 437 \text{ mm.}$$

Pra, një dimension prej 430 mm mbetet jashtë tolerancës së përcaktuar.

AK në vendimin e tij deklaron se Komisioni ka rimatur mostrën dhe ka konstatuar 46 cm.

Kemi, pra, një konflikt faktik të qartë dhe lehtësisht të verifikueshëm.

Për këtë arsye kërkojmë që Eksperti Shqyrtues/OSHP të bëjë ose të urdhërojë një matje fizike të mostrës së pozicionit nr. 10, me instrument matës, sipas mënyrës profesionale të matjes së mbështetëses dhe me rezultat të dokumentuar.

Një dimension objektiv nuk duhet të vendoset vetëm mbi bazën e deklarimeve

kontradiktore, kur mostra fizike ekziston dhe mund të matet drejtpërdrejt.

7.7. Pozicioni nr. 12 – Mbështetëse statike në vend të mbështetëseve multifunkionale 5D

Për pozicionin nr. 12, Dosja e Tenderit ka përcaktuar qartë:

“Mbështetëset e duarve: mbështetëse multifunkionale 5D nga aliazh alumini i ri, të rregullueshme në disa drejtime.”

Kjo nuk është vetëm kërkesë estetike. Është kërkesë funksionale konkrete.

Mostra e OE Galanteria SH.P.K., gjatë verifikimit fizik, kishte mbështetëse statike dhe të palëvizshme.

Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar se mbështetëset e mostrës janë 5D. Në vend të kësaj, në përgjigjen e tij është mbështetur në faktin se fotografia e vendosur në Dosjen e Tenderit nuk përputhet plotësisht me përshkrimin tekstual dhe se kërkesa mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë.

Ky arsyetim nuk mund të qëndrojë.

Përshkrimi tekstual është i qartë: **5D dhe të rregullueshme në disa drejtime.**

Një mbështetëse statike nuk realizon as funksionin themelor të rregullimit dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalente me një mbështetëse multifunkionale 5D.

Edhe nëse fotografia e vendosur në Dosjen e Tenderit është në kundërshtim me tekstin, kjo paqartësi është krijuar nga vetë AK. Ajo nuk mund të zgjidhet pas hapjes së ofertave duke hequr praktikisht kërkesën funksionale 5D në mënyrë që një produkt statik të konsiderohet i pranueshëm.

Neni 40.2 i Rregullores ndalon ndryshimin, modifikimin apo heqjen e specifikimeve gjatë vlerësimit.

Po ashtu, një mbështetëse statike nuk mund të trajtohet si devijim i vogël nga një sistem 5D. Dallimi prek drejtpërdrejt funksionalitetin e produktit.

Sistemet 2D, 3D, 4D apo 5D dallojnë për shkallën dhe drejtimet e rregullimit; ndërsa një mbështetëse statike nuk ofron fare rregullimin e kërkuar. Prandaj kalimi nga 5D në statike nuk është një diferencë e vogël, por eliminim i funksionit të kërkuar.

Kërkojmë nga OSHP që ta verifikojë fizikisht mostrën dhe të konstatojë:

- a janë mbështetëset statike apo të rregullueshme;
- cilat lëvizje konkrete mund t'i realizojnë;
- a plotësojnë kërkesën “multifunkionale 5D”;
- a plotësojnë kërkesën “të rregullueshme në disa drejtime”.

Nëse mbështetëset janë statike, oferta nuk përmbush kërkesën e shkruar të Dosjes së Tenderit.

7.8. Pozicioni nr. 34 – Ndryshimi i gjendjes fizike të mostrës pas dorëzimit

Në datën 14.07.2026, OE Galanteria SH.P.K. ka dorëzuar për pozicionin nr. 34 një karrige me rrota. Gjendja e mostrës në momentin e dorëzimit është dokumentuar me fotografi.

Gjatë qasjes në dokumentacion dhe mostra më 10.08.2026 është konstatuar se e njëjta mostër nuk ishte më në gjendjen fillestare dhe rrotat ishin hequr.

Në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, AK ka pranuar se rrotat janë hequr gjatë procesit të verifikimit nga Komisioni dhe se ato ruhen te Autoriteti Kontraktues.

Pra, në këtë pikë nuk kemi më vetëm pretendim të IBM SH.P.K., por pranim nga vetë AK se është ndërhyrë fizikisht në mostrën e dorëzuar.

Neni 37.6 i Rregullores përcakton se mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderit dhe pjesë e testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e tenderit.

Po ashtu, Neni 38.2 përcakton se gjatë sqarimit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet ndryshim në çmim apo në ndonjë kusht tjetër material ose aspekt të tenderit.

Komisioni duhet të vlerësojë produktin e dorëzuar nga OE në gjendjen në të cilën është dorëzuar, dhe jo ta modifikojë fizikisht produktin për të krijuar një konfigurim tjetër gjatë vlerësimit.

Nëse rrotat nuk kishin rëndësi për përputhshmërinë e produktit, atëherë kërkohet të sqarohet **përse janë hequr**.

Nëse prania e rrotave ndikonte në përputhshmërinë teknike, atëherë ndërhyrja është edhe më problematike, sepse mostra është ndryshuar pas përfundimit të afatit për dorëzim.

Për këtë arsye kërkojmë që OSHP të administrojë:

- fotografinë e mostrës në momentin e dorëzimit;
- fotografinë e gjendjes së saj më 10.08.2026;
- procesverbalin e pranim;
- kodin e mostrës;
- dokumentimin e Komisionit për heqjen e rrotave;
- arsyen dhe momentin kur është bërë ndërhyrja;
- gjendjen në të cilën mostra është vlerësuar përfundimisht.

7.9. Përfundim lidhur me pretendimet e paraqitura

Pretendimet e IBM SH.P.K. nuk bazohen vetëm në dyshime apo interpretime subjektive.

Ekzistojnë çështje faktike dhe teknike të verifikueshme: autorizimi i vitit 2019 i referohet një “above-mentioned tender” të paidentifikuar; marrëveshja e vitit 2017 parashikon marrëveshje të veçanta për projekte më të mëdha; certifikata EN 16955 është në emër të një kompanie tjetër nga prodhuesi i deklaruar; testimet duhet të lidhen me artikujt dhe modelet konkrete; dimensionin 1420 mm është shpallur nga AK si “gabim” vetëm pas hapjes së ofertave; ekziston pretendim serioz për ngatërrimin e mostrës së IBM SH.P.K. me mostrën e një operatori tjetër; ekziston konflikt lidhur me materialin MDF; konflikt objektiv lidhur me dimensionin 430/460 mm; mbështetëse statike janë pranuar përkundër

kërkesës 5D; dhe Komisioni ka pranuar se ka ndërhyrë fizikisht në mostrën nr. 34.

Për disa prej këtyre çështjeve vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar faktet themelore, por ka nxjerrë përfundime juridike që, sipas IBM SH.P.K., bien në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe parimin se kërkesat nuk mund të ndryshohen pas dorëzimit të ofertave.

Për këtë arsye kërkojmë që OSHP/Eksperti Shqyrtues të bëjë shqyrtim dhe verifikim të plotë të secilit pretendim, duke administruar dokumentacionin origjinal, mostrat, fotografitë, raportet e testimit, procesverbalet e Komisionit dhe çdo provë tjetër të nevojshme.

Në veçanti kërkojmë:

- verifikimin e drejtpërdrejtë të dokumenteve të autorizimit pranë Compotek S.r.l.;
- verifikimin e certifikatës EN 16955 në raport me prodhuesin e kërkuar;
- verifikimin e modeleve konkrete që mbulohen nga EN 1335 dhe EN 16139;
- identifikimin dhe testimin e mostrës së IBM SH.P.K. për pozicionin nr. 6;
- verifikimin teknik të materialit MDF për secilin produkt të kontestuar;
- matjen fizike të pozicionit nr. 10;
- verifikimin funksional të mbështetëseve 5D për pozicionin nr. 12;
- verifikimin e plotë të gjurmueshmërisë dhe ndryshimit të mostrës nr. 34.

Sipas Nenit 40.6 të Rregullores, një tender konsiderohet i përgjegjshëm kur është në pajtueshmëri administrative me Dosjen e Tenderit, është në pajtueshmëri teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e Dosjes dhe është dorëzuar nga operatori që plotëson kriteret e përzgjedhjes.

Për rrjedhojë, nëse nga verifikimi i OSHP-së konstatohet se oferta e OE Galanteria SH.P.K. nuk përmbush një ose më shumë nga kërkesat materiale dhe të detyrueshme të FPO-së, kjo ofertë nuk mund të trajtohet si tender i përgjegjshëm.

Kërkojmë që ankesa e IBM SH.P.K. të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim dhe Njoftimi mbi Vendimin e AK-së dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, me urdhër që gjatë rivlerësimit të verifikohen në mënyrë të plotë dhe objektive të gjitha çështjet e ngritura në këtë ankesë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si rezultat i shkeljeve të pretenduara dhe të argumentuara në këtë ankesë, IBM SH.P.K. konsideron se i është shkaktuar dhe vazhdon t'i kërcënohet **dëm material dhe ekonomik**, për shkak se është cenuar mundësia e saj për trajtim të barabartë, vlerësim të ligjshëm të ofertës dhe mundësia për t'u shpërblyer me kontratë në këtë aktivitet të prokurimit.

Dëmi i pretenduar rrjedh drejtpërdrejt nga mënyra e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nga Autoriteti Kontraktues, në veçanti nga trajtimi si i përgjegjshëm i një tenderi për të cilin IBM SH.P.K. ka paraqitur prova dhe pretendime konkrete për

mospërputhje me kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Nëse pretendimet e paraqitura në këtë ankesë vërtetohen dhe konstatohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur një ose më shumë nga kërkesat materiale të Dosjes së Tenderit, atëherë IBM SH.P.K. konsideron se është dëmtuar drejtpërdrejt nga një proces vlerësimi që nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat e LPP-së dhe të dokumentacionit të tenderit.

Dëmi material përfshin, ndër të tjera, shpenzimet e bëra për përgatitjen e ofertës, përgatitjen dhe sigurimin e dokumentacionit teknik, sigurimin e dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara, përgatitjen/prodhimin dhe transportimin e mostrave, angazhimin e personelit dhe resurset tjera të përdorura për pjesëmarrjen në këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu, IBM SH.P.K. konsideron se ekziston dëm ekonomik në formën e **humbjes së mundësisë reale për t'u shpërblyer me kontratë**, në rast se pas shqyrtimit dhe rivlerësimit konstatohet se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk ka qenë tender i përgjegjshëm, ndërsa oferta e IBM SH.P.K. është dashur të trajtohet dhe renditet në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në pajtim me **Nenin 111 paragrafi 1.8 të LPP-së**, me këtë ankesë IBM SH.P.K. paraqet edhe **pretendim për kompensimin e dëmit material**, pasi shkeljet e pretenduara të Autoritetit Kontraktues i kanë shkaktuar ose kërcënojnë t'i shkaktojnë dëm material ankuesit.

Gjithashtu, në pajtim me **Nenin 118 paragrafi 5 të LPP-së**, nëse një apo më shumë prej pretendimeve të paraqitura nga IBM SH.P.K. konstatohen si të vlefshme, kërkojmë që OSHP të shqyrtojë edhe çështjen e dëmeve të shkaktuara si pasojë e shkeljeve të Autoritetit Kontraktues dhe të veprojë në përputhje me kompetencat e saj ligjore për përcaktimin dhe kompensimin e dëmit. Neni 118.5 i jep panelit shqyrtues mundësinë që, kur pretendimi konstatohet i vlefshëm, të caktojë llogaritjen e dëmit dhe të urdhërojë AK-në për pagesën e dëmit të konstatuar.

Në këtë fazë, **shuma përfundimtare e dëmit material nuk mund të përcaktohet në mënyrë të plotë**, pasi ajo varet edhe nga rezultati përfundimtar i procedurës ankimore dhe nga konstatimet e OSHP-së lidhur me ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Për këtë arsye, IBM SH.P.K. kërkon që pretendimi për dëm material të merret në shqyrtim dhe rezervon të drejtën që, sipas kërkesës së OSHP-së dhe në bazë të rezultatit të procedurës, të paraqesë dokumentacionin përkatës për **përcaktimin dhe argumentimin e shumës së dëmit të shkaktuar**.

Kërkojmë që, në rast se ankesa dhe pretendimet tona aprovohen si të bazuara, të zbatohen të gjitha mjetet juridike dhe masat korrigjuese të parashikuara nga LPP-ja, duke përfshirë edhe trajtimin e kërkesës për kompensimin e dëmit material.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:
Bashkëngjitur kësaj Kërkesë për Rishqyrtim paraqiten këto dokumente dhe prova:*

Në mbështetje të fakteve dhe pretendimeve të paraqitura në Pikën 7 të kësaj ankese, IBM SH.P.K. bashkëngjit dhe propozon administrimin e dokumenteve dhe provave si në vijim:

A. Dokumentet që i bashkëngjiten ankesës

1. Ftesa për Ofertim/Dosja e Tenderit për aktivitetin e prokurimit me nr. **220/70010-26-5478-5-5-8**, “Furnizim me Inventar Administrativ për repartet Pediatrike & Internistike Spitali i Përgjithshëm Prizren”, përfshirë Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Dosja përcakton, ndër të tjera, kërkesën për autorizim nga prodhuesi, certifikimin e prodhuesit, testimet EN 1335 dhe EN 16139 për artikuj konkretë, dorëzimin e mostrave dhe katalogët/broshurat e prodhuesit.

2. B12 – Procesverbali i Hapjes së Tenderëve, datë **14.07.2026**.

3. B58 – Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë **06.08.2026**.

4. Letra standarde për tenderuesin lidhur me rezultatin/eliminimin e IBM SH.P.K.

5. Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga IBM SH.P.K., së bashku me të gjitha provat dhe fotografitë e bashkëngjitura me të.

6. Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim, datë **14.08.2026**, me të cilin kërkesa e IBM SH.P.K. është refuzuar si e pabazuar.

7. Dokumenti “**Cooperation Agreement**”, datë **20.05.2017**, i paraqitur në dokumentacionin e OE Galanteria, në të cilin subjekti kosovar paraqitet si “Galanteria LLC” dhe ku parashihet se për projekte më të mëdha palët do të arrijnë marrëveshje të veçanta me kushte të veçanta.

8. Dokumenti “**Manufacturer Authorization**”, datë **22.03.2019**, i paraqitur nga OE Galanteria SH.P.K., për të cilin është ngritur pretendimi lidhur me identifikimin e subjektit të autorizuar, fushëveprimin dhe referencën “above-mentioned tender”.

9. Certifikata **EN 16955:2017**, nr. R 50625995 0001, në të cilën si **License Holder** figuron **Korea Gas Spring Co., Ltd.**, ndërsa produkti i certifikuar identifikohet si “Tapered pressure tubes”.

10. Certifikatat, raportet e testimit dhe atestet EN 1335 të paraqitura nga OE Galanteria SH.P.K. për artikujt nr. **10, 11 dhe 12**.

11. Certifikatat, raportet e testimit dhe atestet EN 16139 të paraqitura nga OE Galanteria SH.P.K. për artikujt nr. **6, 29 dhe 34**.

Këto dokumente propozohen si prova për krahasimin ndërmjet modelit të testuar, modelit të paraqitur në katalog dhe mostrës fizike të dorëzuar, pasi FPO i ka lidhur shprehimisht testimet me këta artikuj konkretë.

12. Katalogët dhe/ose broshurat e prodhuesit të paraqitura nga OE Galanteria SH.P.K. për artikujt e kontestuar, për krahasimin e modeleve të ofertuar me modelet e paraqitura në raportet e testimi dhe me mostrat fizike.

13. Fotografitë e mostrës së **pozicionit nr. 6 – Karrige Bari**, përfshirë fotografitë dhe dëshmitë e matjes së mostrës së OE të rekomanduar.

Dosja kërkon dimensione **450 x 460 x 1420h mm**, identitet me specifikacionin dhe tolerancë $\pm 5\%$.

14. Fotografitë dhe provat lidhur me mostrën e IBM SH.P.K. për pozicionin nr. 6, me qëllim të verifikimit se karrigia të cilës AK i ka atribuar shkëputjen/defektin gjatë testimi nuk ka qenë mostra e IBM SH.P.K.

15. Fotografitë e produkteve të kontestuara lidhur me përdorimin e materialit **MDF/iverpallakë**, për artikujt për të cilët Dosja e Tenderit kërkon shprehimisht MDF.

16. Fotografitë dhe dëshmitë e matjes së **pozicionit nr. 10**, ku IBM SH.P.K. ka konstatuar gjerësi të mbështetëses rreth **430 mm**, ndërsa Dosja kërkon minimum **460 mm**.

17. Fotografitë e mostrës së **pozicionit nr. 12**, të cilat paraqesin mbështetëset statike të duarve, për krahasim me kërkesën e FPO-së për **“mbështetëse multifunksionale 5D ... të rregullueshme në disa drejtime”**.

18. Fotografia e mostrës së **pozicionit nr. 34 në datën 14.07.2026**, në gjendjen në të cilën është dorëzuar nga OE Galanteria SH.P.K.

19. Fotografia e të njëjtës mostër të **pozicionit nr. 34 gjatë qasjes më 10.08.2026**, pas heqjes së rrotave, për të dëshmuar ndryshimin e gjendjes fizike të mostrës pas dorëzimit.

20. Çdo fotografi, komunikim, procesverbal apo dokument tjetër që IBM SH.P.K. ka siguruar gjatë qasjes në dokumentacionin dhe mostrat e aktivitetit konkret të prokurimit dhe që lidhet me pretendimet e paraqitura në këtë ankesë.

B. Dokumentet dhe provat që kërkojmë të administrohen nga OSHP/Eksperti Shqyrtues

Përveç dokumenteve të bashkëngjitura, për shkak se një pjesë e provave ndodhen në posedim të Autoritetit Kontraktues, OE të rekomanduar, ARBK-së ose prodhuesit Compotek S.r.l., kërkojmë nga OSHP/Eksperti Shqyrtues që gjatë shqyrtimit të ankesës të sigurojë dhe administrojë edhe:

a) Dokumentacionin e plotë historik të ARBK-së për Galanteria për datën **20.05.2017**, me emrin zyrtar të biznesit, formën juridike, numrin e regjistrimit/NUI, adresën dhe përfaqësuesin e autorizuar;

b) Dokumentacionin historik të ARBK-së për të njëjtin subjekt për datën **22.03.2019**, me qëllim të krahasimit të identitetit juridik me dokumentin “Manufacturer Authorization”;

c) Konfirmimin zyrtar dhe të drejtpërdrejtë nga **Compotek S.r.l.** lidhur me autenticitetin e “Cooperation Agreement” të datës 20.05.2017 dhe “Manufacturer Authorization” të datës

22.03.2019, identitetin e subjektit të autorizuar, fushëveprimin e autorizimit dhe identifikimin e “above-mentioned tender”;

d) Origjinalin ose kopjen e plotë dhe të pacenuar të dokumentit “Manufacturer Authorization” të datës 22.03.2019;

e) Të gjitha raportet e plota të testimit EN 1335 dhe EN 16139, duke përfshirë faqet që identifikojnë modelin, kodin/referencën, fotografinë dhe konfigurimin e produktit të testuar;

f) Regjistrin/procesverbalin e pranimit të mostrave të datës 14.07.2026;

g) Evidencën e **kodimit të mostrave**, përfshirë kodin që i është caktuar secilit produkt dhe lidhjen e tij me operatorin përkatës;

h) Fotografitë zyrtare të mostrave të bëra nga AK në momentin e pranimit dhe gjatë testimit/vlerësimit;

i) Procesverbalin ose raportin e testimit të mostrës së pozicionit nr. 6 dhe identifikimin e saktë të mostrës për të cilën AK pretendon se ka pësuar shkëputje/defekt;

j) Procesverbalin, shënimin zyrtar apo dokumentin tjetër mbi bazën e të cilit Komisioni ka konstatuar se materialet e kontestuar janë MDF;

k) Identitetin dhe kualifikimin profesional të personit/personave që kanë bërë verifikimin teknik MDF/iverpllakë;

l) Procesverbalin ose dëshminë e matjes së Komisionit për pozicionin nr. 10, ku AK pretendon se gjerësia e mbështetëses është 46 cm;

m) Dokumentacionin mbi verifikimin e funksionalitetit të mbështetëseve të duarve për pozicionin nr. 12;

n) Dokumentacionin, procesverbalin dhe arsyetimin e Komisionit për **heqjen e rrotave nga mostra e pozicionit nr. 34**, përfshirë datën, personin që ka kryer ndërhyrjen dhe arsyen për të cilën është ndryshuar konfigurimi i mostrës;

o) Ekzaminimin fizik të mostrave që vazhdojnë të ruhen te Autoriteti Kontraktues, në veçanti për pozicionet nr. **6, 10, 12 dhe 34**, dhe sipas nevojës kryerjen e matjeve dhe verifikimeve teknike nga persona me ekspertizë profesionale përkatëse.

Kërkojmë që të gjitha provat e mësipërme të vlerësohen në ndërlidhje me njëra-tjetrën dhe jo të izoluar, në mënyrë që të përcaktohet gjendja e plotë dhe e saktë faktike lidhur me përgjegjshmërinë e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe ligjshmërinë e procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pozizioni nr: 6

1280mm





Pozizioni nr: 10



430MM

A photograph of a grey office chair with black armrests, partially wrapped in clear plastic. A red horizontal line is drawn across the seat, with the text '430MM' in red below it. The chair is on a light-colored, textured floor. In the background, other chairs are visible, some also wrapped in plastic.

Pozizioni: 12



Pozizioni: 12














Pozizioni nr: 34



Add a Caption

e hënë, 10 gusht 2026 në 12:12

[Adjust](#)

IMG_1120

Apple iPhone 16 Pro Max

HEIF



Main Camera — 24 mm $f1,78$

24 MP • 4284 × 5712 • 3,1 MB

STANDARD


ISO 100

24 mm

0 ev

$f1,78$

1/1385 s



DATE: 10/08/26 SUN MON TUE WED THU FRI SAT SPT MON WED

NOTES

Pozicioni nr: 6

Ulesja: 450x460mm

Mbeshitetesja: 450x450mm

Lartesia nga toka: 1170mm

DATE: 10/08/26 SUN MON TUE WED THU FRI SAT SUN MON

NOTES

Pozicioni nr: 10

Ulesja: 500x 480 mm

Mbeshtetësja: 760x 430 mm

Lartësia nga toka: 1280 mm